



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 40.2 pika c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L - 040 dhe nenin 34.2 pika c të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2012, mori:

### **VENDIM**

#### **PËR MBËSHTETJE NË REALIZIMIN E PROJEKTIT – RIKONSTITUIMI I NGJARJES SË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË**

##### **Neni 1**

Unioni i Kritikëve dhe Shkrimtarëve Shqiptar Prishtinë – Tiranë – Shkup – Podgoricë, për realizimin e projektit:

Rikonstituimi i ngjarjes dhe shënimi i jubileut të 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në Vlorë më 28 nëntor 2012.

Për mbulimin e shpenzimeve për tre kamionë për transportim të kuajve dhe një autoambulancë dhe pesë kombi për kalorës, ekip veterinerësh dhe stafin tjetër përcjellës, mbështetet me 1.500 l. derivate – naftë.

##### **Neni 2**

Furnizimi me derivate bëhet në Kompaninë përfituese në procedurën e prokurimit për furnizim me derivate të automjeteve zyrtare të Komunës.

Drejtori i Drejtorisë së Administratës e ngritë Komisionin e veçantë për pranim dorëzimin e sasisë së derivateve sipas nenit 1 të këtij vendimi.

##### **Neni 3**

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

**Nr. 01/221-02**  
**Podujevë,**  
**23 nëntor 2012**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hazir Raçi**